



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 294/4 prot.

Tiranë, më 30.03.2026

V E N D I M

Nr. 26, datë 30.03.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË TË
PROCEDURËS SË PEZULLIMIT TË NDJEKUR NË RASTIN E NËPUNËSES
BRUNILDA MENALLA, NGA INSTITUCIONI I KOMISIONERIT PËR
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën nr. 294 prot., datë 11.02.2026, paraqitur nga nëpunësja Brunilda Menalla, në të cilin parashtrihen pretendime për parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë aplikimit të institutit të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

Në përmbajtje të informacionit të administruar, parashtrohet se nëpunësja në fjalë, me aktin nr. 146 prot., datë 25.01.2024, me lëndë “Kërkesë për pezullim statusi nëpunësi civil”, ka kërkuar pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil nga pozicioni “Specialist i Marrëdhënieve me Jashtë”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, për

një periudhë 2-vjeçare, për shkak të emërimit në pozicionin “Këshilltare” në të njëjtin institucion.

Më tej, me Urdhrin nr. 16, (nr.260 prot.), datë 02.02.2026, të Komisionerit, nëpunësja është liruar nga pozicioni “Këshilltare”, e njëkohësisht, me Urdhrin nr. 17, (nr.260/1 prot.), datë 02.02.2026, të Komisionerit, është vendosur përfundimi i afatit të pezullimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, duke e njoftuar nëpunësen se, pozicioni i mëparshëm i punës është plotësuar dhe në strukturën organizative të institucionit nuk ka vende vakante.

Duke mos qenë dakort me sa më sipër, nëpunësja i është drejtuar Komisionerit duke kërkuar verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në aplikimin e institutit të pezullimit në shërbimin civil, nga ana e organeve të ngarkuara me detyra konkrete në këtë rast.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi u njoh me aktet e administruara, ashtu si u evidentua më sipër, vlerësoi se ka dyshime të arsyeshme për parregullsi të lejuara gjatë administrimit të shërbimit civil, e në këto rrethana ka filluar procesin e verifikimit të informacionit. Nëpërmjet shkresës nr. 294/1 prot., datë 06.03.2026, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 294 prot., datë 11.2.2026, dërguar nga nëpunësja Brunilda Menalla”, të Komisionerit, është njoftuar institucioni për fillimin e verifikimit të kësaj procedure, duke i kërkuar dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 522/1 prot., datë 10.03.2026, me objekt: “Kthim Përgjigje kërkesës për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr.294 prot., datë 11.02.2026, të dërguar nga nëpunësja Brunilda Menalla”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr.294/2 prot., datë 23.02.2026, ka dërguar dokumentacionin në të cilin materializohet procedura e pezullimit të nëpunëses nga shërbimi civil.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar rezulton se, me aktin nr. 1524 prot., datë 07.10.2019, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpunëses në fjalë, emëruar pas konkurrimit, në pozicionin “Specialiste e Marrëdhënieve me Jashtë” në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, i është deklaruar statusi i punësimit si “nëpunës civil”, në këtë pozicion pune.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit, nëpunësja në fjalë, mbështetur në pikën 12, germa c), të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 17.02.2016, “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, i ndryshuar, me anë të aktit nr. 146 prot., datë 25.01.2024, me

lëndë: “*Kërkesë për pezullim statusi nëpunësi civil*”, ka kërkuar pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil nga pozicioni “*Specialist i Marrëdhënieve me Jashtë*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, për një periudhë 2-vjeçare, për shkak të emërimit në pozicionin “*Këshilltare*” në të njëjtin institucion.

Më tej, me Urdhrin nr. 16, (nr. 260 prot.), datë 02.02.2026, të Komisionerit, nëpunësja është liruar nga pozicioni aktual si “*Këshilltare*”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe me Urdhrin nr. 17, (nr. 260/1 prot.), datë 02.02.2026, me lëndë: “*Për përfundimin e pezullimit të statusit të nëpunësit civil të znj. Brunilda Menalla*”, të Komisionerit, për këtë nëpunëse është deklaruar përfundimi i periudhës së pezullimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

Referuar përmbajtjes së aktit të ndërprerjes së pezullimit, në pikën 2, sqarohet se:

“...në përfundim të periudhës së pezullimit, znj. Brunilda Menalla nuk mund të rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës, për shkak se ky pozicion rezulton i plotësuar, si dhe për faktin se në strukturën organizative të institucionit nuk ka asnjë vend të lirë vakant...”

Në këto rrethana, për sa i takon ligjshmërisë së aplikimit të institutit të pezullimit, vlerësojmë se duhet të analizohet baza ligjore që e rregullon këtë institut të ligjit.

Në interpretim të pikës 1, të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe dispozitave të kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 17.02.2016, “*Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, i ndryshuar, njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore ka detyrimin ligjor për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për sistemimin e nëpunësit civil pas përfundimit të periudhës së pezullimit.

Në rastin konkret, duke qenë se sistemimi i menjëhershëm i nëpunëses në pozicionin e mëparshëm të punës apo në një pozicion tjetër të barazvlefshëm, ka rezultuar i pamundur, njësia përgjegjëse ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke e regjistruar në listën e pritjes.

Në këtë mënyrë, njësia përgjegjëse, pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka përmbushur detyrimet e saj ligjore, duke ndjekur procedurën e përcaktuar dhe garantuar vijimësinë e statusit të nëpunësit civil, nëpërmjet regjistrimit në listën e pritjes, me aktin nr.272 prot., datë 03.02.2026, “*Lista e nëpunësve civilë që kanë përfunduar periudhën e pezullimit*”.

Sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse, se në përputhje me pikën 18, të kreut II të Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, i ndryshuar, ky organ ka detyrimin që, në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, për të cilin nëpunësja plotëson kriteret e pozicionit të punës,

të ndërmarrë pa vonesë hapat përkatëse për transferimin e saj, duke respektuar përparësinë e nëpunësve të regjistruar në listën e pritjes.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit nr. 294 prot., datë 11.02.2026, të paraqitur nga nëpunësja Brunilda Menalla, me objekt verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së pezullimit, meqënëse procedura është kryer në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe nëpunësja Brunilda Menalla.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)